

VENDIM
Nr. 2510, datë 9.5.2022

(NË EMËR TË REPUBLIKËS)
PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË
“BRUM” SHPK, SHOQËRI NË PROCEDURË FALIMENTIMI

Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë e përbërë nga:

Alma Kodraliu gjyqtare,

asistuar prej Sekretares Gjyqësore Klodjana Bishaj, sot, më datë 9.5.2022, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

KËRKUESE: shoqëria tregtare “Brum” sh.p.k. me NIPT L71604056D, shoqëri në procedurë falimentimi, shpallur sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë, nr. regj. them. 8823, datë 26.2.2021, përfaqësuar nga administratorja e falimentimit, znj. Shpresa Breçani.

OBJEKTI: 1. Miratimin e raportit të administratores së falimentimit të datës 9.5.2022, “Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë ‘Brum’ sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi”.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin” dhe VKM-në nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e standardeve kombëtare të administrimit të masës së falimentimit”.

Gjykata, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k, dëgjoi këtë të fundit në seancën gjyqësore të datës 9.5.2022, shqyrtoi edhe raportin e përgatitur nga ana e administratores së falimentimit të emërtuar: “Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi”, dëgjoi edhe përfaqësuesit e kreditorëve të shoqërisë “Brum” sh.p.k. të cilët ishin dakord me përfundimin e procedurës së falimentimit të “Brum” sh.p.k.,

VËREN:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë, me vendimin nr. 8823/3740 regj. Themeltar, datë 26.2.2021, ndër të tjera ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkesit, shoqëria “Brum” sh.p.k.

- Hapjen në orën 14:55 të datës 26.2.2021, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., me administrator znj. Aulona Sula, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Perlat Rexhepi”, rezidenca “Ivanaj”, nr. 12 dhe nr. 13, Tiranë.

- Emërimin si administratore të falimentit për shoqërinë “Brum” sh.p.k., të znj. Shpresa Breçani, e regjistruar në listën e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, me nr. rendor 243, me adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë nga parkimi, Tiranë.

2. Vendimi gjyqësor i sipërcituar rezulton të ketë marrë formë të prerë, për shkak se palët ndërgjyqëse nuk kanë ushtruar ankimum.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë, me vendimin e datës 18.10.2021, rezulton që në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, të ketë vendosur:

1. Pranimin e kërkesës së Administratores së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k.

2. Miratimin e Raportit të Administratores së Falimentimit të datës 18.10.2021.

3. Miratimin e Komitetit të Kreditorëve të shoqërisë në falimentim “Brum” sh.p.k., të përbërë nga:

- Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë, me përfaqësues z. Medi Duka;

- Personi fizik “Selma Gabrani”, me përfaqësues znj. Selma Gabrani;

- Shoqëria “Garden line” sh.p.k., me përfaqësues av. Julian Shkjezi.

4. Në vijim të veprimtarisë së saj, administratorja e falimentit të shoqërisë “Brum” sh.p.k. rezulton që, në përputhje me përcaktimet e ligjit kuadër nr. 110/2016, “Për falimentimin” dhe në përputhje edhe me përcaktimet e VKM-së nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e Standardeve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit” të ketë hartuar raportin përkatës për shpërndarjen e masës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar se si do shpërndahet masa e falimentimit.

5. Referuar përmbajtjes së procesverbalit të datës 25.2.2022 rezulton që të jetë miratuar në mënyrë unanime nga ana e anëtarëve të Komitetit të Kreditorëve, lista e shpërndarjes së kreditorëve, sipas radhës së përparësisë të përcaktuar në ligjin nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

6. Referuar përmbajtjes së raportit të realizuar nga ana e administratores së Falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k. të emërtuar “Për miratimin e shpërndarjes përfundimtare” dhe raportit “Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë ‘Brum’ sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi”, rezulton të jenë hartuar në përputhje me përcaktimet e ligjit kuadër nr. 110/2016, “Për falimentimin”, si dhe në përputhje edhe me përcaktimet e VKM-së nr. 733, datë 13.11.2019, “Për miratimin e Standardeve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit”, dhe, konkretisht, në përputhje me nenet 48, 49, 50 dhe 53 të ligjit të sipërcituar, dispozita këto në të cilat rezulton që të jenë përcaktuar ndër të tjera edhe caktimi i shpërblimit për administratoren e falimentimit dhe anëtarët e Komitetit të Kreditorëve.

7. Me vendimin e datës 4.3.2022 nga ana e Gjykatës rezulton të jetë vendosur:

1. Pranimin e Kërkesës së Administratores së Falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k.

2. Miratimin e shpërndarjes përfundimtare së masës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi, sipas raportit të datës 4.3.2022, të realizuar nga ana e administratores së falimentimit znj. Shpresa Breçani, në shumën 681,377 lekë të miratuar nga Komiteti i Kreditorëve, për kreditorët përfitues, radhës së shpërndarjes dhe vlerave respektive, sipas tabelës në këtë raport.

8. Pas vendimmarrjes së sipërcituar, nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k. rezulton që të jetë proceduar me shpërndarjen e masës së falimentimit, duke shlyer për këtë qëllim shpenzimet e procedurës së falimentimit, shpërblimin e administratores së falimentimit, shpenzimet e anëtarëve të Komitetit të Kreditorëve, pagesën e kreditorëve të falimentimit.

9. Pas përfundimit të shpërndarjes së masës së falimentimit nga ana e administratores së falimentimit, në kushtet ku është bërë shpërndarja e masës së falimentit dhe shoqëria nuk disponon më pasuri të tjera për shitje dhe për arkëtimin e shumave të tjera, rezulton që të jetë kërkuar përfundimi i procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim.

10. Ish-administratorja e shoqërisë “Brum” sh.p.k. znj. Aulona Sula ka depozituar pranë sekretarisë gjyqësore kërkesën për zhblokimin e llogarive individuale. Për sa i përket, bllokimit të llogarive të ish-administratores, neni 90 i ligjit “Për procedurat tatimore”, parashikon se, nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të kësaj ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo banke, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të bllokojë një shumë e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet: a) shumës që kërkohet të mbahet; b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Vazhdimi i bllokimit të llogarive të ish-administratores nuk përbën sens, përderisa është hapur dhe po përfundon procedura e falimentimit. Referuar nenit 38, pika “d”, të ligjit nr. 110/2016, organet tatimore konsiderohen kreditorë të preferuar për detyrimet që rrjedhin nga tatimet dhe taksat e papaguara prej 1 viti nga paraqitja e kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

Referuar përmbajtjes së raportit të paraqitur nga administratorja e falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., nga ana e gjykatës do të merren në shqyrtim fakti nëse ekzistojnë apo jo kushtet për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim, referuar

për këtë qëllim përcaktimeve të nenit 153 të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, dispozitë kjo e emërtuar “Përfundimi i procedurës së falimentimit”.

Në dispozitën e sipërcituar rezulton që të parashikohet shprehimisht:

“1. Pasi ka përfunduar shpërndarja përfundimtare, gjykata e falimentimit vendos përfundimin e procedurës së falimentimit.

2. Pagesa e plotë për të gjithë kreditorët e falimentimit në çdo fazë të procedurës është një shkak për përfundimin e procedurës.

3. Vendimi i gjykatës dhe arsyet e përfundimit shpallen publikisht.

4. Në rastin e personave juridikë, kur të gjithë kreditorët shlyhen plotësisht, atëherë shpërndarja e plotë e të ardhurave pas likuidimit të pasurisë sjell prishjen e personit juridik. Në këtë rast, administratori i falimentimit dërgon vendimin e gjykatës së falimentimit në regjistrat përkatës, në mënyrë që të fshijë debitorin nga këta regjistra.

5. Në rastin e personave fizikë, zbatohen dispozitat e pjesës së shtatë të këtij ligji.”.

Në rastin konkret sikurse rezulton që të jetë përcaktuar edhe në raportin e paraqitur nga ana e administratores së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim rezulton që nga ana e kësaj të fundit të jetë përfunduar shpërndarja e masës së falimentimi, si dhe kjo e fundit nuk rezulton që të disponojë pasuri të tjera për shitje, si dhe nuk rezulton të ketë shuma të tjera për të arkëtuar.

Në rrethanat e sipërcituara arrihet në përfundimin, se në përputhje me përcaktimet e nenit 153, pika 1, të ligjit nr. 110/2016, datë 27.10.2016, “Për falimentimin”, plotësohen kushtet për ta deklaruar të mbyllur procedurën e falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim për shkak se nga ana e administratores së falimentit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., rezulton që të ketë përfunduar shpërndarja përfundimtare e masës së falimentimit.

Në arritjen e një përfundimi të tillë, gjykata vlerëson të mbajë parasysh edhe faktin se Komiteti i Kreditorëve rezulton që të ketë qenë unanimisht dakord me raportin e administratores së falimentit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., shoqëri në falimentim .

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata në zbatim të neneve 126, 306–310 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në zbatim të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 733, datë 13.11.2019, “Për Miratimin e Standardeve Kombëtare të Administrimit të Masës së Falimentit”,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k.

2. Urdhërohet zhbllokimi i llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë në emër të ish-administratores së shoqërisë znj. Aulona Sula.

3. Urdhërohet botimi i një kopjeje të shkurtuar të këtij vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

4. Urdhërohet administratorja e falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k. znj. Shpresa Breçani që të depozitojë vendimin e përfundimit të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k. në regjistrat përkatës, me qëllim fshirjen si debitore të shoqërisë “Brum” sh.p.k. nga këta regjistra.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, afat i cili për të gjitha palët e procedurës së falimentimit fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 9.5.2022.

GJYQTAR
Alma Kodraliu

SEKRETARE
Klodjana Bishaj

Shpenzime gjyqësore: S'ka.